


# A flisni gjuhë të ndryshme në shtëpi? Kjo është diçka e mirë për fëmijën tuaj!

Këshilla për të edukuar fëmijën tuaj në gjuhë të ndryshme





# Flisni me fëmijën tuaj gjuhën që ju vetë flisni më mirë!

## Kjo është:

- gjuha që flisni vetvetiu
- gjuha që kuptoni dhe flisni më së miri
- gjuha në të cilën mendoni
- gjuha në të cilën ëndërroni
- zakonisht gjuha juaj amtare

## Mendohuni mirë që përpara:

- Flisni rreth kësaj me partnerin tuaj përpara se të lindë fëmija juaj.
- Zgjidhni një sistem të cilin mund ta zbatoni.
- Një person mund të flasë gjithmonë një gjuhë të caktuar: përshembull, babai flet holandisht, mamaja flet frëngjisht
- Në situata të caktuara mund të flisni një gjuhë te caktuar: ne flasim gjithmonë holandisht rrugës për në shkollë dhe në shkollë, në shtëpi dhe me familjen flasim gjuhën tonë të shtëpisë.
- Flisni gjithmonë në të njëjtën gjuhë gjatë një bisede.

## **Flisni shumë me fëmijën tuaj! Kështu fëmija juaj do ta ketë më të lehtë të mësojë të flasë dhe të kuptojë çfarë thonë të tjerët.**

- Flisni me fëmijën tuaj që pas lindjes.
- Flisni shumë. Përshkruani çfarë shikoni ose çfarë bëni: kur visheni, hani, lani, bëni pazarin, shtroni tavolinën...
- Stimuloheni fëmijën tuaj të flasë edhe vetë. Bëjini pyetje: “Pse të pëlqen kjo?”, “Si ka mundësi që...?”

## **Luani me fëmijën tuaj! Kështu fëmija juaj do mësojë të flasë më shpejt.**

- Zgjidhni aktivitete që ju pëlqejnë si juve ashtu edhe fëmijës tuaj: të këndonni bashkë një këngë, t’i lexoni, të luani futboll, të shëtisni në park, të luani me puzzle, të vizatoni, të ngjyrosni,...
- Gjatë lojës ju mund të:
  - thoni se çfarë shikoni, si përshembull ngjyra, sende, lëvizje, ndjenja
  - të bëni pyetje, si: ‘A ecin makina dhe biçikleta me të njëjtën shpejtësi?’
  - Vini në dukje lidhjet: ‘Është vjeshtë, dielli nuk shkëlqen më aq shumë, gjethet bien nga pema’.

## **A bën fëmija juaj ndonjë gabim? Përsëriteni fjalinë në mënyrë korrekte. ,Kështu fëmija juaj e mëson më shpejt fjalinë e duhur.**

- Fëmija juaj thotë: “Babi shtëpi vjen?”. Ju përgjigjuni: “Po, babi po vjen në shtëpi.”
- A është fëmija juaj 6 vjeç ose më i madh? Atëherë mund t’i tërhiqni vëmendjen kur bën një gabim. Bëjini pyetje të tipit: ‘Si duhet t’a thuash?’, ‘Në ç’kuptim?’, ‘Çfarë doje të thoje?’
- Vërinë në dukje fëmijës tuaj gjërat që bën mirë.

## **A ndodh që fëmija juaj nganjëherë i përzien gjuhët? Kjo është normale.**

- Jepni vetë shembullin e duhur. Flisni vetëm një gjuhë.



## **Që t'i mësoni fëmijës tuaj gjuhë të ndryshme, kjo kërkon kohë!**

- Të folurit dhe kuptuarit e holandishtes në shkollë kërkon më shumë kohë se të shprehurit në gjuhën e përditshme.
- Fëmija juaj do flasë më shpesh holandisht në shtëpi:
  - Tregojini që i jepni rëndësi holandishtes.
  - Shpjegojini pse ju duket e rëndësishme të flisni edhe në gjuhën tuaj amtare.
  - Flisni me fëmijën tuaj rreth gjuhëve të ndryshme. Pyeteni atë se si ndihet rreth kësaj.

## **Fëmija juaj mund të jetë më i heshtur kur mëson një gjuhë të re.**

- Fëmijët e mësojnë gjuhën duke dëgjuar dhe vëzhguar.
- Përgjatë 3 muajve ata janë më të heshtur.
- Çfarë mund të bëni ju?
  - Lëreni fëmijën tuaj të luajë me fëmijë të tjerë që flasin gjuhën tjetër.
  - A thotë fëmija juaj fjalë në gjuhën tjetër? Tregojini që kjo ju gëzon.
  - Tregoni interes për gjuhën tjetër, edhe kur nuk e dini.
  - Guxoni të flisni edhe ju në gjuhën tjetër, siç bëni me komshiun tuaj ose mësuesin. Lejohet të bëni gabime!

## A e flet dhe e kupton mirë fëmija juaj gjuhën që flisni në shtëpi? Atëhere e ka më të lehtë të mësojë holandishten.

- Disa shembuj:
  - i njeh fëmija juaj ngjyrat në gjuhën që flisni në shtëpi?  
Atëhere i mban mend më lehtë në holandisht.
  - A thotë fëmija juaj fjali me 4 fjalë në gjuhën që flisni në shtëpi?  
Atëhere i krijon më shpejt fjalitë me fjalë në holandisht.

## Tregoni që është kënaqësi të flasësh holandisht!

- Lëreni fëmijën tuaj të tregojë diçka në holandisht.
- Shkoni së bashku në bibliotekë dhe merrni libra të bukur në holandisht
- Organizoni aktivitete argëtues dhe ftoni fëmijë të tjerë. Kështu fëmija juaj do flasë holandisht edhe jashtë shkollës.
- Shkoni së bashku në një aktivitet diku afër, regjistroni fëmijën tuaj në një qendër rinore ose klub sportiv...
- Shikoni së bashku lajmet ose një program televiziv në holandisht.
- Flisni holandisht me mësuesin, në dyqan...
- A mësoi diçka të re fëmija juaj? Tregoji që kjo ju gëzon: "I ke mësuar të gjitha ngjyrat në holandisht? Do mi mësosh edhe mua?"



## A e ka të vështirë fëmija juaj të mësojë gjuhën (në të folur e të kuptuar)? Flisni me shkollën!

- Shkolla e ndihmon fëmijën tuaj të mësojë gjuhën.



## Heb je vragen?

Neem dan contact op met het Expertisecentrum Anderstaligen (ECA).

Rolderbrink 128-130

Tel: 0591-334501

[www.eca-emmen.nl](http://www.eca-emmen.nl)

Deze folder is beschikbaar in de volgende talen:

- Albanees
- Arabisch
- Bulgaars
- Duits
- Engels
- Farsi
- Frans
- Kroatisch
- Pools
- Roemeens
- Russisch
- Servisch
- Slovaaks
- Tigrinya
- Turks

De printversie is te downloaden via de website [www.eca-emmen.nl](http://www.eca-emmen.nl).





## Colofon

Een uitgave van de gemeente Emmen



Bron: Stad Gent

## Bezoekadres

Raadhuisplein 1, 7800 RA Emmen

Telefoon: 14 0591

[gemeente.emmen.nl](http://gemeente.emmen.nl)

[gemeente@emmen.nl](mailto:gemeente@emmen.nl)